



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TË EKONOMISË

Nr. 17 Prot

Datë, 21.04.2020

VENDIM
Nr.4, datë 21.04.2020

PËR
SHTYRJEN E PROÇESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES
TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË, PËR ANËTARËT E
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË NJËSINË KRYESORE NË FAKULTETIN E
EKONOMISË NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në zbatim të nenit 7, pika 6/d, nenit 18, pika 3 të Vendimit të Senatit Akademik Nr. 59, datë 11.02.2020 “Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë; Vendimit të Komisionit Zgjedhor pranë Fakultetit të Ekonomisë Nr.1, datë 20.03.2020 “Për Shpalljen e fituesit të Kryetarit të Komisionit Zgjedhor pranë Fakultetit të Ekonomisë (KZFE); Urdhërit të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 99, datë 26.03.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin Nr. 8, datë 14.01.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”; si dhe referuar Vendimit të Komisionit Zgjedhor pranë Fakultetit të Ekonomisë Nr. 3, datë 27.03.2020 “Për shtyrjen e Procesit të Regjistrimit të Kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë, për Anëtarët e Komisioneve të Përhershme në Njësinë Kryesore në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë”,

Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Ekonomisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë shtyrjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë, për Anëtarët e Komisioneve të Përhershme në Njësinë Kryesore në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë.
2. Të miratojë periudhën kohore të regjistrimit të kandidatëve datën 27.04.2020, deri në datën 01.05.2020, brenda orarit zyrtar 8:00-16:00.
3. Procesi i regjistrimit kryhet kur kandidati paraqitet personalisht pranë Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Ekonomisë, ambjenti A 206, kati i dytë në Fakultetin e Ekonomisë, për të depozituar dokumentacionin për kandidim. Pas regjistrimit, kandidati

pajiset me vërtetimin e regjistrimit si kandidat nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Ekonomisë.

4. Vendimi afishohet në të gjitha mjediset e Fakultetit të Ekonomisë, si dhe publikohet në faqen web www.univlora.edu.al.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i Komisionit Zgjedhor të Fakultetit:

Grigor Dede

Anëtar

Ilira Pulaj

Desantila Ahmeti

Sekretare

Briseida Ramaj